

## KONTRATE SHITJE KUOTASH

**PALA SHITËSE:** Dashamir Begu, atësia Xhemal, e lindur më 23.11.1962 në Tiranë, dhe banues në Tiranë me adresë Rruga Todi Shkurt; Njësia Bashkiake nr 2, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit ID me numër personal **G21123062T**.

Në këtë akt do të quhet «Palë Shitëse».

**PALA BLERËSE:** Klarisa Xhibraku, atësia Beram, e lindur më 10.07.1986, në Durrës, dhe banuese në Durrës me adresë Rruga Veli Xhymerti; Lagja nr 7, madhore e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit me numër personal **I65710084W**.

Në këtë akt do të quhet «Pala Blerëse».

**BAZA LIGJORE:**

1. Ligji Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare"
2. Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë;

Personat si më sipër identifikuar, me vullnet të lirë dhe të plotë, me kërkesë të shprehur personalisht, të informuar e në dijeni të pasojave ligjore ne rast deklarimi të pavërtetë hartojnë këtë akt.

Sot më **20/09/2023** u mblohdën palët për sa më poshtë vijon:

### RRETHANA PARAPRAKE

- Shoqëria "INFISSI24 CONSTRUCTION" shpk është person juridik shqiptar me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe regjistruar sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit, e identifikuar me numër NUIS: M32025007Q, nuk është në proces falimentimi, nuk është në ndjekje penale, nuk është nën sekuestro apo nën forma të tjera të kufizimit të zotësisë së saj juridike dhe është e lirë për qarkullim civil të pjesëve të kapitalit të saj.
- Personi, palë shitëse, si më sipër është pronar në Shoqërinë "INFISSI24 CONSTRUCTION" shpk, duke zotëruar:
  - Dashamir Begu ortak i subjektit dhe zotëron 1 kuotë me pjesëmarrje në përqindje 100% të kuotave të kapitalit, me vlerë 200.000 (dyqind mijë) lekë.

### OBJEKTI I KONTRATËS

Objekti i kësaj kontrate është:

- Shitja e 1 (një) kuote të ortakut Z. Dashamir Begu, me pjesëmarrje në përqindje 50%, me vlerë në para 100.000 (njëqind mijë) lekë me përfituese znj. Klarisa Xhibraku.

### ÇMIMI I KONTRATËS

Me marrëveshje të përbashkët të dy palët kanë përcaktuar se:

- Klarisa Xhibraku do paguajë çmimin total për blerjen e 1 (një) kuote të kapitalit të zotëruar nga Dashamir Begu prej 100.000 (njëqind mijë) Lek, me pjesëmarrje në përqindje 50%;
- Palët deklarojnë se çmimi total për shitblerjen është likujduar totalisht nga blerësi përpara nënshkrimit të aktit.
- Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Pala Shitëse, humbet çdo të drejtë pronarie mbi pjesët e shitura të kapitalit dhe mbetet pronare e 1 (një) kuote të ortakut me pjesëmarrje në përqindje 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit me vlerë në para 100.000 (njëqind mijë) lekë dhe Pala Blerëse bëhet pronare e 1 (një) kuote të ortakut me pjesëmarrje në përqindje 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit me vlerë në para 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate pronësia mbi kapitalin e shoqërisë do të bëhet si vijon:

- |                          |  |
|--------------------------|--|
| 1. Z. Dashamir Begu      | <b>1 (një) kuote</b><br>Pjesëmarrja në përqindje: <b>50%</b> ; Me Vlerë në para 100.000 lekë |
| 2. Znj. Klarisa Xhibraku | <b>1 (një) kuote</b><br>Pjesëmarrja në përqindje: <b>50%</b> ; Me Vlerë në para 100.000 lekë |

### DEPOZITIME TË PALËVE

Palët depozitojnë dhe kërkojnë që kontratës t'i bashkangjiten dhe të jenë pjesë integrale të saj edhe:

- Ekstrakt i Regjistrimit Tregtar të Shoqërisë "INFISSI24 CONSTRUCTION" shpk.
- Dokumentacioni i identifikimit të palëve.

Ky akt përpilohet në katër kopje, kopje të aktit ruhen nga palët dhe depozitohen pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për t'u pasqyruar ndryshimi i pronësisë së shoqërisë INFISSI24 CONSTRUCTION shpk sipas detyrimeve ligjore.

Pasi kontrata lexohet me zë, palët deklarojnë se e gjejnë tërësisht, e paragraf për paragraf me perputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, japin pëlqimin e tyre për gjithçka më sipër dhe e nënshkruajnë aktin rregullisht duke vendosur emër mbiemër dhe firmë.

**PALA SHITËSE**  
Dashamir Begu

*Dashamir Begu*  
*[Signature]*



**PALA BLERËSE**  
Klarisa Xhibraku

*Klarisa Xhibraku*  
*[Signature]*